

Statut
i
Shoqerise "ReeLit" sh.p.k.

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:
Data e Themelimit,
Emri dhe Themeluesit

Sot, më 19.12.2022, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: **ReeLit sh.p.k**

- Themeluesit e shoqërisë:

Z. Kujtim Hasa, i biri i Zyber, shtetas shqiptar, lindur më 01.11.1961 në Vilë, Kukës, banues në Elbasan, mbajtës i kartës së identitetit me Nr letërnjoftimi: 034921135 dhe Nr Personal: G11101071F, në cilësinë e ortakut të shoqërisë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Znj. Ajda Fetahu, e bija e Arif, shtetase shqiptare, e lindur më 22.08.1995 në Elbasan, banues në Elbasan, mbajtës i kartës së identitetit me Nr Letërnjoftimi: 033112399 dhe Nr Personal: J55822061B, në cilësinë e ortakut të shoqërisë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

- Forma dhe emri ligjor i shoqërisë: **ReeLit sh.p.k**

Neni 2:
Objekti


Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Zhvillim i platformës ëeb dhe mobile për marrjen e urimeve, video-ve live, chat mesazhe.
- Ndërmjetësues midis klientëve dhe talentëve, artistëve, politikanëve, këngëtarëve, aktorëve etj, nëpërmjet aplikacioneve ëeb dhe mobile
- Ofrimin e Konsulencave dhe marketing-ut për sektorin e content creation dhe dërgimit të video-ve, live chat nga talentët, artistët, këngëtarët, aktorëve dhe klientëve.
- Përdorimin e aplikacioneve ëeb dhe mobile të dhëna në përdorim nga shoqëri të tjera
- Të kryejë aktivitet publikimi dhe reklamimi
- Të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore, aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër.
- Shoqëria kryen cdo lloj aktiviteti që bën pjesë ne objektin e saj, dhe që lidhet dhe që e mbështet atë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 3:
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me **afat te pacaktuar**



Neni 4:
Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Hotel Skampa, Bulevardi Qemal Stafa 3001 Elbasan zona kadastrale 8521 dhe nr Pasurisë 1/66.

Asambleja e ortakëve ka kompetencën të hapë filiale e agjenci të tjera dhe të mbyllë ato, nëse e konsideron të nevojshme.

Kapitali

Neni 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **10,000 Lekë** (dhjetë mijë lekë)

1. Ortakët themelues dhe kuotat e zotëruara prej tyre në Shoqëri janë si mëposhtë:
 - **Kujtim Hasa** : Zoterues i **1 (një)** kuote prej 80% ose me vlerë të përgjithshme 8,000 (tetë mijë lekë) që përben 80% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - **Ajda Fetahu** : Zoterues i **1 (një)** kuote prej 20% ose me vlerë të përgjithshme 2,000 (dy mijë lekë) që përben 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Ortaku që kërkon të transferojë kuotën e tij, tek të tretët, tërësisht apo pjesërisht, është i detyruar që fillimisht të rezervojë ortakut tjetër të drejtën e parablerjes. Për të lejuar ushtrimin e kësaj të drejte, ortaku që dëshiron të transferojë kuotën e tij duhet të lajmërojë me shkrim (me letër-rekomandë) gjithë ortakët që figurojnë në Statut (në shtëpinë e secilit, me adresat që rezultojnë në këtë statut), duke e specifikuar çmimin e shtijes, mënyrën e pagesës dhe emrat e blerësve të mundshëm.



E drejta e parablerjes i qendron gjithëmonë ortakut të shumicës dhe ky i fundit ka të drejtë 6 muaj që të marrë një vendim për blerjen osë refuzimin.

Në rast se asnjëri nga ortakët në vecanti apo asambleja në përgjithësi nuk përgjigjen brenda 6 (muajve), nga data e njoftimit të ofertës, miratimi i transferimit krijohet I dhënë nga ortaku ofertues, dhe ky I fundit është I lirë ta transferojë kuotën tek të tretët

Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
 - j) mbylljen e shoqërisë

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Për të shmangur çdo dyshim asambleja e ortakëve mund të marrë çdo vendim në rast se plotësohet numri I aksionarëve që kanë mbi 70% të kuotave, çdo vendim i marrë nga aksionarët që kanë mbi 70% të kuotave do të hyj në fuqi në mënyrë të menjëhershme.

Neni 9 Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se $\frac{3}{4}$ e aksioneve, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12

Përfshirja nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:

- Kujtim Hasa, shtetas shqiptar, lindur në Vilë, Kukës, më datë 01.11.1961, me kartë identiteti me nr. 034921135, dhe nr. ID G11101071F.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare në nënshkrimin e kontratave të ndryshme;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut dhe cdo detyrë të lënë nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Miratimi i bilancit kryhet nga ortakët me $\frac{3}{4}$ e votave dhe zotërues të kapitalit.

Në çdo rast që shoqëria ka të ardhura dhe është fitimprurëse, do të shpërndajë dividend, vetëm në rast se Asambleja e Ortakëve vendos ndryshe ti alokojë fondet për investime në platformën online.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në perfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat (3/4) e votave të zotuesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Nëse shoqëria priset, atëherë aksionari i pakicës nuk lejohet në asnjë mënyrë që të hapë apo të krijojë një shoqëri me të njejtin funksion dhe qëllim si ReeLit, për të paktën një periudhë 3 vjecare.

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te lindre midis Shoqërisë dhe të tregëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKET

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Z. Kujtim Hasa

Znj Ajda Fetahu

Ky dokument shërben edhe si akt themelimi i shoqërisë "ReeLit" SHPK